



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 141/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, në seancën e panelit të mbajtur me 07.10.2013, mori këtë:

### V E N D I M

**Konstatohet e tërhequr ankesa** Anr. 141/2013 e datës 03.10.2013 e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj

### Arsyetim

PZAP, ka pranuar një kërkesë për tërheqje të ankesës Anr.141, datë 06.10.2013, nga subjekti politik LVV me të cilën pala ankuese kërkon që mos të shqyrtohet ankesa e lartcekur, me arsyetimin se subjekti politik në fjalë ka kërkuar ndjesë për një akt të tillë nëse kjo vepër është kryer nga anëtarët e tyre.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës Anr. 141/2013, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos ta shqyrtoj ankesën në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 141/2013 më datën 07.10.2013

